



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 19.06.2026

PROCESVERBAL

**Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ,
biznese dhe fermerë për
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029
I mbajtur më 10.06.2026 (e mërkurë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën **26.05.2026**.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Kalendari-i-protokolluar.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Kalendar-i-protokolluar.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=psfbid02yrHsDF9BngXR2Y3CSbvFy8XhXVzvwBQQCjWgiNGCZE6y3z6mwWzb1HMjRZYE6DAcFl&id=100066575766996

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1bPYBF9PLU/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftimi-ne-uebfaqe-Degjimi-1-i-protokolluar.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:00** dhe ka përfunduar në **ora 12:00**.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **20 pjesëmarrës, prej tyre 20 meshkuj dhe 0 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, i cili fillimisht ka përshëndetur të pranishmit.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Pa humbur kohë, po fillojmë me KAB-in, e cila përfshin buxhetin për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029. Kjo kornizë është pjesë ligjore e Ministrisë së Financave, e cila na dërgon Qarkoren Buxhetore, me të cilën tregon limitet e shpenzimeve të cilat planifikohen për komunat, në të gjitha kategoritë buxhetore. Për këtë vit, për fat të keq, jam i detyruar t'ju lajmëroj se ndarjet buxhetore bëhen në bazë të numrit të popullsisë, dhe ju e dini që me censusin e fundit ne kemi një rënie të popullsisë. Kjo ka reflektuar diku në 800 mijë euro ulje të buxhetit për këtë vit në Komunën e Dragashit. Në anën tjetër, kemi rritje buxhetore në raport me vitin e kaluar, por, duke e pas parasysh që janë rrit kostot, inflacionin, kjo rritje, me minus 800 mijë – edhe pse duket si rritje, faktikisht ne me këto mjete nuk mund të kryejmë punë sa kemi krye viteve tjera që kemi pas buxhet më të vogël. Për mos me ju humb shumë kohë, po ju tregoj për të gjitha kategoritë se si e kemi bërë shpërndarjen e buxhetit. Buxheti në total është **14,043,470 euro**. Për Paga dhe Mëditje kemi ndarë **7,230,000 euro**; për Mallra dhe Shërbime kemi ndarë **2,013,000 euro**; për Shpenzime Komunale kemi planifikuar **400,000 euro**; për Subvencione dhe Transfere kemi planifikuar **591,000 euro**; kurse për Investime Kapitale kemi ndarë **3,808,147 euro**. Nga buxheti i përgjithshëm për Investime Kapitale, e kemi ndarë në tri grupe: për komunitetin joshumicë në vlerën 40% dhe 60% për atë shumicë, pasi i kemi hequr 350 mijë euro si investime të përbashkëta, ku janë: investimet kapitale 210 mijë euro, Fondi Rezervë që përfshin 100 mijë euro, dhe 40 mijë euro subvencione që vijnë si investim i përbashkët. Nga këto na kanë mbetur 3,440,000 euro që të ndahen për të dy komunitetet. Për komunitetin shumicë janë planifikuar 2,064,000 euro, kurse për komunitetin joshumicë (40%-shi) 1,376,000 euro. Unë e di se qytetarëve më shumë u intereson se ku janë planifikue investimet kapitale. Mallrat dhe Shërbimet janë kryesisht mjete të cilat i mbulojnë shpenzimet operative të investimeve kapitale dhe mirëmbajtjen dhe funksionimin e Administratës, por gjithashtu i plotësojnë shpenzimet e Arsimit dhe Shëndetësisë. Sikur viteve tjera, edhe këtë vit Ministria ndan Grantin Specifik për Arsim dhe Grantin Specifik për Shëndetësi. Granti Specifik i Arsimit është në vlerë 4,924,000 euro, kurse Granti për Shëndetësi është 1,000,815 euro. Po filloj me leximet e listës së projekteve të planifikuara kapitale dhe pas kësaj ju mund të bëni propozimet tuaja për projekte konkrete, të cilat pastaj mund t'i paraqesim në Kuvend, në mënyrë që të mund t'i fusim si projekte në këtë Listë preliminare. Sa i përket komuniteti joshumicë, po i lexojmë vetëm shumat, pasi që ende nuk

i kanë emërtuar projektet dhe ne, për të mos humbur kohë, i kemi publikuar vetëm shumat e planifikuara sipas fshatrave. Ndërsa, sa i përket komunitetit shumicë, do t'i lexojmë projektet së bashku me shumat e parapare për secilin projekt.

Për subvencione sivjet kemi paraparë më shumë, për shoqërinë civile. Në Kulturë, Rini dhe Sport janë 180 mijë euro. Vlera totale, afër 600 mijë euro janë vetëm subvencione që kemi me i dhënë në bujqësi, pastaj nga Zyra e Kryetarit, në Kulturë, Rini e Sport, në Shëndetësi dhe në Administratë. Për herë të parë kemi arrit me dhënë subvencione në vlerë 600 mijë euro, dhe unë mendoj se do të kenë mundësi të gjitha OJQ-të të aplikojnë për veprimtaritë e tyre.

Vetim Ramadani, nënkryetar i Komunës: Vetëm deshta me të plotësue te pjesa e subvencioneve. Përveç atyre kategorive, kishte edhe subvencione në sferën e arsimit. Meqenëse vitin e kaluar dhe këtë vit jemi ballafaquar me probleme të jashtëzakonshme sa i përket pagesave për bursa, ndërsa planifikojmë që prej vitit të ardhshëm të fillojmë ta rrisim edhe vlerën e bursave për studentë, gjithashtu do t'i përfshijmë edhe disa kategori të cilat më herët nuk kanë qenë, siç janë kategoritë e studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit. Faleminderit!

Burim Piraj, përfaqësues i bizneseve: Ju përshëndes! Për shkak se nuk kam shumë kohë, deshta me e marrë fjalën në fillim. Shumë jam i dëshpëruar me këtë projektbuxhet. Hiq kubëza, vën kubëza, shtro asfalt për bjeshkë... kush shkon në bjeshkë me asfalt?! A lopët kanë me shkue në asfalt, a? Unë e shfrytëzoj qat asfalt, dal me motorr edhe dal me ec. Kush e shfrytëzon, çka po bën Komuna jonë? As nuk e përmendet lidhjen e Dragashit me Maqedoninë. As nuk e përmendet lidhjen e Dragashit me Shqipërinë. Ku po shkojmë na kështu? Ju mundeni me e mbush asfalt krejt Komunën, edhe kubëza, edhe nesër askënd nuk e ke këtu, krejt kanë me u shpërngul prej këtu. Ky është buxhet totalisht i gabuar. Asnjë pikë nuk jau pashë që e keni bo të mirë. Sa u përket investimeve kapitale, zero. Në Dragash ka shumë pak, si qytet, investime, janë shumë të vogla, me ato të Zaplluxhes që i prezantuat janë në disproporcion shumë të madh. Një katund edhe një qendër këtu, ku na prezanton neve, është shumë disproporcion i madh. Unë nuk e di këto qysh i keni bo, po unë ju lutem në mënyrë shumë miqësore, vëllazërore, ta rishikoni këtë projektbuxhet që e keni bërë, se është katastrof. Edhe Pllava është i vetmi katund që nuk lidhet me asnjë katund tjetër me rrugë. Krejt i keni lidhë. Bone hesap, Zlipotokun me Brodin me udhë, leprat edhe thitë e egër veç ecin aty. Unë po kërkoj falje që është komuniteti joshumicë, po unë goranët i konsideroj si vëllezërit e mi, mos më keqkuptoni, nuk bëj diferencë mes Gorës dhe Opojës. Mirëpo, është projektbuxhet total i keq. Edhe ju kisha lut, amani bëni diçka për këtë popull, që ky vend me u zhvillue. Derisa nuk çilet rruga për Maqedoni, edhe nuk çilet rruga për në Shqipëri, me kalue autobusat, shliperat, njerëzit me qarkullue, Dragashi mos me qenë zorrë qorre, na kemi mbarue. Po kërkoj falje, unë duhet me qenë i sinqertë, duhet me jua thënë të

vërtetën që e mendoj. Është gabim i madh, ju prapë bëni çka të doni, vetëm ta dini se është gabim total. Ju faleminderit shumë që patët durim me m'dëgjue! Ju uroj punë të mbarë dhe ditë të mirë!

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Ky është debat. Ke plotësisht të drejtë, por pikërisht këtu është debati me qytetarët dhe fshatrat po i paraqesin kërkesat vetë. Buxheti është i qytetarëve. Në të shumtën e rasteve, kur bëjmë takime e qytetarë, i paraqesin këto probleme. Po pajtohem, krejt në rregull, po janë kërkesa të qytetarëve.

Vetim Ramadani, nënkryetar i Komunës: Unë po e shfrytëzoj rastin vetëm një përgjigje të shkurtë me ia dhënë zotërisë, se vërshimet që kanë ndodhë në fshatin Mlikë, kanë ndodhë vitin e kaluar, edhe procedura tenderuese për riparimin e vërshimeve në fshatin Mlikë është këtë vit. Ne këtu jemi mbledhë për vitin e ardhshëm. E, për gjëra tjera mundemi me diskutue, nuk është telashe. Ne këtu jemi mbledhë për vitin 2027, që ta kemi të qartë. Ndërsa, riparimi i dëmeve që kanë shkaktuar vërshimet në vitin 2025, është këtë vit i planifikuar. Është në procedurë tenderimi. Kështu që, nuk është e nevojshme ne me e qit në vitin e ardhshëm një gjë që jemi duke e bërë sivjet. Tash, sa u përket kritikave të z.Burim Piraj. Drejtor Qamili u tregue shumë i sinqertë dhe nuk i lexoi emrat e projekteve që i kanë sjellë komuniteti joshumicë, meqenëse nuk i kanë ende definitive. Dua të të jap një informatë, meqenëse ishe konkret në rrugë të caktume, përmende segmente të caktume. Rruga Restelicë-Mavrovë, prej Restelicës, ti edhe unë plot herë e kemi ec atë rrugë, deri në kufi është e asfaltuar. Ne kemi marrë masa, sivjet e kemi procedurën e tenderimit rruga transit që kalon prej Jellakit të Krushevës, që kalon në dalje, në krye të Restelicës, në mënyrë që me e siguroe bajpasin për kalim. Kjo është sivjet, është projekti. Tash, pjesën tjetër, ne kemi pas një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Komunën e Mavrovë-Rostushës, kemi zhvillue tri takime. Tash, për me qenë aktive qajo rrugë, duhet me pas bashkëpunim në të dy anët. Për tonën, kjo që ta thashë unë qëndron, edhe e kemi në procedurë, janë edhe paratë e alokuara për sivjet. Vetëm, fillimisht e kemi pas një debat publik në Restelicë, meqenëse një pjesë ka rezistuar, por është kryer. Edhe një temë tjetër që e hape, lidhjen e fshatit Pllavë me fshatrat tjerë. Lidhjen e fshatit Pllavë me fshatin Buqe e kemi në projekt, mirëpo ky projekt nuk është investim kapital, është me Mallra dhe Shërbime, sepse fillimisht kemi me e bo trasimin e asaj rruge. Është traseja ekzistuese, mirëpo duhet me u zgjerue. Fatmirësisht, edhe në Kadastër, vetëm tri prona janë private, pjesa tjetër është komplet si pronë publike. Kjo na ka dhënë një lehtësi të jashtëzakonshme dhe me Mallra e Shërbime vetëm kemi me e zgjerue. Të njëjtin veprim e kemi praktiku edhe me lidhjen e fshatit Pllavë deri te shpia e Kosovës atje lart. Dhimbja jote edhe e jona, e përbashkët, është çështja e lidhjes së Dragashit me Shqipërinë përmes Grykës së Lumit Pllava. Këtu vitin e kaluar – ti je në dijeni shumë mirë – ne kemi ndarë edhe mjete për këtë rrugë. Problemi nuk ka qenë tek ne. Kemi ndarë mjete, mirëpo problemi ka qenë se kemi has në problem sa u përket pronave

edhe procedurave të shpronësimit. Ti shumë mirë e dish se aty është një investitor. Ai investitori e ka blerë pjesën dërmuese të të gjitha pronave që gjenden në atë pjesë. Tash, ne e kemi marrë në shqyrtim atë çështje, jemi takuar edhe me ta. E vetmja shpresë e jona për me e rregullue atë rrugë është që këtë vit përfundon trafostacioni në Shajne. Në momentin që montohet trafostacioni qendror i KOST-it, ne i kërkojmë zyrtarisht Hidrocentralit poshtë që është, me e kalue kabllon, me e lidhë me Shajnen, sepse ka me qenë një pavarësi energjetike e Komunës së Dragashit. Atëherë ne jemi të lirë me e vazhdue trasenë për teposhtë. E vetmja formë është kjo. Mundim me e diskutue. Edhe për çështjen e shpërndarjes së investimeve, ne si Komunë shpërndarjen e buxhetit e bëjmë konform numrit të banorëve, edhe konform ligjit. Pavarësisht a dëshirojmë a nuk dëshirojmë ne, a ka apo nuk ka banorë me një fshat të caktuar, në momentin që – prej censusit të fundit, prej regjistrimit të popullsisë – ai fshat ka kaq banorë, ne jemi të obliguar me ia nda mjetet. Tash, ta zëmë shembull, Restelica është fshati më i madh në pjesën e Gorës. Ne nuk jemi askushi që t'ia përcaktojmë se ku dëshirojmë me i çue investimet e veta. E kemi të pamundur këtë punë. Po edhe nga ana njerëzore, në qoftë se dikush mangu ujësjellës, kanalizim edhe kubëzim, nuk mundesh ti me kërkue diçka tjetër. Janë kërkesa të qytetarëve. Këtë që e lexoi drejtori i Financave është puro kërkesa që kanë ardhë prej qytetarëve dhe prej përfaqësuesve të fshatrave. Ndërsa, sa u përket disa investimeve që janë kapitale edhe në vlerë më të madhe që janë kryesisht të fokusuara në Dragash, apo me projekte madhore siç ka qenë Ujësjellësi, ose ndërtimi i dy deponive, këto janë vizioni i Qeverisë Lokale. Sepse për ne, ta zëmë, në fshatin Orqushë dhe në fshatin Rrenc kanë me u ndërtue dy deponi, por kjo nuk është çështje që hyn në proporcion me numrin e banorëve të secilit fshat. Këto janë investime të përbashkëta të të gjithë Komunës së Dragashit. Sepse, edhe qytetari nga Brodi, edhe ai nga Zaplluxhja, mbeturinat ka me i dërgue në Rrenc, respektivisht në Orqushë. Ndërsa, investimet që janë nëpër fshatra, ekskluzivisht janë kërkesa të banorëve dhe nevoja të qytetarëve. A janë të mjaftueshme? Nuk janë. Edhe në qytezën e Dragashit kemi investime jashtëzakonisht të mëdha. Nuk është investim i vogël me e sjellë ujësjellësin në Dragash; nuk është investim i vogël me iu ndërrue 6 objekteve të Komunës, me iu ndërtue edhe kulmet, me u lye prej nga brenda, me u instalue ndriçimi i ri, me u vesh shkallët sërish, me u bo izolimi i fasadës. Është investim prej 900 mijë euro. Faleminderit!

Shehat Ibraimi, përfaqësues komunitetit joshumicë nga Dragashi: Zoti drejtor, së pari do t'ju lutesha nëse mund të më shpjegoni ndarjen e buxhetit për Dragashin, pasi shoh se aty është ndarë diçka 26.000, pastaj plus diçka tjetër. Si e ndani atë buxhet për Dragashin dhe ku shkojnë ato mjete?

Ajo që më intereson mua si përfaqësues i Dragashit të Poshtëm është se çfarë mund të aplikojmë ne nga Dragashi i Poshtëm nga këto mjete, nëse është e mundur.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Investime të përbashkëta ne kemi paraparë 210 mijë euro për Dragashin. Mirëpo, 26 mijë euro i ka ndarë komuniteti joshumicë për disa kërkesa të qytetarëve të Dragashit të Poshtëm. Sepse, edhe kanalizimi që është me shumicë për Dragashin e Ri, e kemi prej buxhetit tonë. Por nuk kemi pas para prej nesh me e krye edhe nalt, e kanë paraparë atë 26 mijëshin. Ju mblidhnu, cilat janë nevojat tuaja kryesore, bjereni listën, për atë është edhe debati, që deri në ditën kur aprovohet buxheti në Kuvend, edhe ju mundeni me e dhënë kontributin me e shti një projekt, brenda kësaj shume, çka është më i nevojshëm. Me rëndësi është që për momentin i kemi këto para. Jemi të gatshëm që në Dragash prej të dy buxheteve, të të dy komuniteteve, me krye punë. Mundesh me qenë pjesë edhe ti, me propozue diçka të re që ne kemi mundur që të mos e planifikojmë.

Sehat Ibraimi, përfaqësues komunitetit joshumicë nga Dragashi: Do t'ju lutesha personalisht që të angazhoheni. Unë tashmë prej tre vitesh vazhdimisht, pra me këmbëngulje, që kur është ndërtuar ai rrugë drejt stadiumit, neve na është dëmtuar rruga për varreza. Rruga për varreza është bërë e pakalueshme, nuk mund të arrijmë as me veturë, e madje as në këmbë nuk mund të shkojmë për të varrosur të afërmit tanë. Rruga e poshtme, me ndërtimin e rrugës së re, është shkatërruar rruga jonë e vjetër. Janë ndërtuar disa mure mbajtëse që juve ju kryejnë punë, por rruga jonë është totalisht e rrënuar.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Sivjet është ai muri mbrojtës duke u rregullue, e dimë atë problem, edhe që kanë shit varrezat, e kemi bërë që deri në mot me e krye krejt. Ai do të kryhet pa problem. Ne po ngutemi, që mos të ndodhë diçka më e keqe e me u zbulue varrezat aty.

Sehat Ibraimi, përfaqësues komunitetit joshumicë nga Dragashi: Së dyti, parku ekzistues, i cili mendoj se në territorin e komunës është një nga investimet më të mira në tre vitet e fundit, sa është shfrytëzuar ai park. Më besoni, aty vijnë njerëz nga Zrza, Shajne, Luboviqte, Kukullanë, Zvanishtë, sjellin fëmijët. Ejani pasdite dhe do ta shihni, parku është plot.

Por ai park, për fat të keq, nuk është përfunduar deri në fund. Zoti atje e di sa bar ka, sa gjarpërinj dalin. Unë jam afër tij. Kam kërkuar 3–4 herë, kam shkuar edhe në kadastër dhe kudo. Të paktën, nëse asgjë tjetër, kositeni barin që fëmijët të mund të luajnë. Dhe nëse mund të shtohen edhe disa lojëra për fëmijë, sepse, më besoni, ndodhin zënka mes fëmijëve pasi nuk ka mjaftueshëm lodra. Nuk mund ta besoj që në Dragash, në qendër të Dragashit, një park i tillë ka më pak lodra sesa në Rapç dhe Krstac, që i kam parë. Kjo është e paarsyeshme. Parku është shfrytëzuar maksimalisht, dhe edhe zoti menaxher e di këtë, sepse edhe shteti tani e ndjek dhe e sheh sa përdoret. Së dyti që doja të kërkoja, si propozim, më çudit fakti që prej vitesh, tani jeni në mandatin e dytë, në Dragash nuk hyn projekti kapital për rinovimin e ujësjellësit, pra rrjetit të ujësjellësit nëpër Dragash. Ne çdo vit kemi 3–4 defekte. Ato gypa të azbestit nuk janë më as të shëndetshëm, ekziston mundësia e infeksioneve dhe e shumë problemeve tjera, dhe shpërthejnë të paktën katër herë në vit. Ju e dini kur ka problem në Dragash — i gjithë Dragashi mbetet pa ujë për 5–6 ditë. Kjo është vërtet problem serioz. Është e çuditshme që kjo nuk hyn në planin e investimeve kapitale. Po bëjmë fasada, të gjitha janë të mira për zbukurim, por gjërat bazike nuk janë zgjidhur. Keni bërë fabrikën e ujit, për këtë ju përgëzoj, por rrjeti dhe furnizimi nuk janë përfunduar. Unë do t'ju propozoj, si qytetar i Dragashit, ta shqyrtoni dhe ta përfshini — ndërtimin e rrjetit kryesor të ujësjellësit nëpër Dragash. Kjo do të kishte rëndësi të madhe për komunën e Dragashit. Qendra administrative e meriton këtë. Faleminderit shumë.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Faleminderit shumë! Sivjet e kemi PZhK-në, problemi e ujit të Dragashit e dijmë shumë mirë. Këtu ne e dimë se atë e menaxhon Hidroregjioni. Ne e kemi lënë lidhjen prej fabrikës, duhet me ia ndërrue krejt rrjetin. Sapo të bëhet PZhK-ja, të caktohen Hartat Zonale, se këtu duhet me u ndërrue komplet trasa, për me mund që sa më pak me bo dëm në infrastrukturë. Ne jemi të gatshëm të investojmë. Vullneti i kryetarit është që, përkundër Hidroregjionit me i lëshuë paratë edhe me e zgjidhë këtë problem, se Dragashi ka gypa të azbestit. Sa i përket parkut, ke plotësisht të drejtë, ne e kemi bërë një park të vogël aty, me qëllim që pak do të dalin e do të luajnë, nuk e kemi dijtë rëndësinë. Tash është një test i mirë, nevoja është me e bo një park të madh. Do ta kemi parasysh që ta planifikojmë. Nëse nuk ka edhe ndonjë pyetje tjetër, e mbyllim këtë takim. Ju faleminderit shumë për pjesëmarrje!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-me-krjetare-te-keshillave-te-fsbatrave-obj-biznese-dbe-fermere-per-kab-2027-2029/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzana-je-budzetsko-saslusanje-sa-predsednicima-seoskib-saveta-nvo-ima-preduzecima-i-poljoprivrednicima-za-sbo-2027-2029/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1GQafpiUV6/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/191nNJnzSc/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 10.06.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME
KRYETARË TË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, OJQ, BIZNESE DHE
FERMERË PËR KAB 2027-2029

LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA
PREDSIEDNICIMA SEOSKIH SAVETA, NVO-IMA, PREDUZEĆIMA I
POLJOPRIVREDNICIMA ZA SBO 2027-2029

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	BURIM PIRAJ	PLAVO	shqip.	✓		
2	Badrin DACTI	Klloce	shqiptar	✓		
3	BRADRIK HADRIĆ	BRESAN				
4	Kufidin Skenderi	DIKAVUCE	shqiptar	✓		
5	ARDIT KALANJARI	KOSOVË	shqiptar	✓		
6	Dreni Myrtetani	ZAPLUVIK	SHQIPTAR	✓		
7	Refikun Kollonin	Kosovë	Shqiptari	✓		
8	Edrisa Haxhiu	Zupluqe	Shqiptar	✓		
9	Armen Gjejmari	Diac	shqiptar	✓		
10	Behar Selmani	KDK	shqiptar	✓		
11	Veton Halili	Zaplluxhe	Shqiptar	✓		
12	Bedri Veliu	Shajme	Shqiptar	✓		
13	Mehmet Beqiri	Buce	shqiptar	✓		
14	Arsoni Beqiri	Biçe	shqiptar	✓		
15	KARL KALAJ	Kosovë	shqiptar	✓		
16	SEHAT IBERIMI	DRAC.	shqiptar	✓		
17	SUAD TORUNI	RTPCA	shqiptar	✓		
18	BEGIR BEQARI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	✓		
19	Gazmend Ramada	BIRUT	SHQIPTAR	✓		
20	Hajri Emin	Zupluqe	shqiptar	✓		
21						
22						
23						
24						

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 453/01-10176/26/2
10.06.2026
Dragash - Dragaš



